



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Ministartstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja



Komuna e Deçanit

Municipality of Deçan

Opština Dečane

Prishtinë, 28/06/2022

Duke u bazuar në nenet 3, 6, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7, 01 mars 2019, Prishtinë), nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe nenin 15 Shtojcën 2 të Rregullores nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), nenet 5 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28, 04 qershor 2008, Prishtinë), si dhe Ligjin Nr. 078/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR UJITJE PËR VITIN 2022

Palët nënshkruese

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e përfaqësuar nga Ministri (në tekstin e mëtejme Ministria);
dhe
2. Komuna e Deçanit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna),.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është financimi i projektit për ujitje për vitin 2022 “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Deçan” – Tipi i kanalit të hapur, si dhe përcaktimi i obligimeve të Ministrisë dhe Komunës për realizimin e projektit në fjalë.

Neni 2 Vlera e projektit

1. Ministria do të financojë projektin Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Deçan” – Tipi i kanalit të hapur, brenda mundësive buxhetore të parapara për vitin 2022.
2. Vlera e parashikuar e investimit është 349,800.00€ treqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind euro), financimi i projektit do të bëhet nga buxheti i vitit 2022, me pjesëmarrje të financimit prej 100% nga Ministria.

3. Vlera e saktë përfundimtare e projektit (investimit) do të përcaktohet në kontratën e lidhur në mes të Ministrisë dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur sipas procedurave të legjislacionit në fuqi të prokurimit publik ku vlen njësoj pjesëmarrja e financimit prej 100% nga Ministria.

Neni 3 **Përgjegjësitë e Ministrisë**

1. Ministria do të ndajë mjetet financiare në shumën e përgjithshme prej 100% të shumës totale të projektit nga neni 1 i kësaj Marrëveshjeje.

2. Mjetet financiare të ndara nga paragrafi 1 i këtij neni ndahen nga Kodi i Programit 40100 Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve – Ministria për vitin 2022, i ndarë në një (1) periudhë në vlerën totale të mbështetjes financiare të projektit në shumën prej 349,800.00€ treqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind euro).

3. Pagesat për periudhën e kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, sipas participimit të Ministrisë, do t'i bëhen operatorit ekonomik sipas kontratës, i cili do të përzgjidhet sipas procedurave të prokurimit nga ana e Ministrisë.

4. Pagesat bëhen vetëm për aktivitetet e përfunduara në bazë të situacioneve të sjellura nga operatori ekonomik, të vërtetuara nga organi mbikëqyrës/menaxheri dhe të verifikuara nga mbikëqyrësi i projektit i emëruar nga Ministria.

5. Pagesat bëhen vetëm për aktivitetet e projektit në fjalë dhe jo për ndonjë aktivitet tjetër.

6. Ministria, në pajtim me legjislacionin në fuqi e bënë vlerësimin e ofertave për zgjedhjen e kontraktuesit.

Neni 4 **Përgjegjësitë e Komunës**

1. Komuna merr për obligim shmangien e pengesave eventuale juridike-pronësore në hapësirat ku realizohet projekti.

2. Komuna në bashkëpunim me Shoqatën, apo grupet të tjera të fermerëve merr për obligim zgjidhjen e të gjitha kontesteve pronësore si dhe probleme të tjera të mundshme që mund të paraqitën gjatë ekzekutimit të punimeve.

3. Zyra kadastrale e Komunës duhet të kontrolloj listat e pronës të fermerëve dhe të raportoj me shkrim mbi të dhënat e pronësisë aty ku investohet, si dhe të ofroj dokumentet të cilat janë të domosdoshme si hartat topografike dhe të gjitha shënimet tjera të cilat do të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve.

4. Në bazë të kriterëve të përcaktuara për investime kapitale në infrastrukturën e ujitjes Komuna në bashkëpunim me anëtarët e shoqatës dhe banorët e lokacionit përkatës janë përgjegjës për largimin e të gjitha derdhjeve të ujërave të zeza - kanalizimeve nga kanalet e ujitjes, që do të rehabilitohen, në të kundërtën punimet do të ndërpriten.

5. Komuna obligohet që të caktoj zyrtarin përkatës si pikë kontakti nga Drejtoria përgjegjëse për bujqësi për komunikim me Ministrinë.

Neni 5 **Përgjegjësitë dhe zotimet e përbashkëta**

1. Ministria ka autoritetin dhe përgjegjësinë të lidhë kontratën me operatorin ekonomik, i cili është vlerësuar si më i përgjegjshmi teknikisht dhe financiarisht dhe të emërojë/përzgjedhë menaxherin/mbikëqyrësin, i cili do të menaxhojë realizimin e projektit.

2. Ministria do të përzgjedhë Kompaninë mbikëqyrëse për zbatimin e Projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

3. Mbikëqyrësi i emëruar/përzgjedhur nga Ministria do t'i raportojë Autoritetit nga i cili është emëruar.

Neni 6

Shqetësimet shtesë të ngritura nga palët

Në rast të keqpërdorimeve eventuale, të cilat rrezikojnë udhëheqjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin dhe konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi, palët zotohen se do të bëjnë njoftim zyrtar te organet përgjegjëse.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që mund të kenë ndërmjet veti, përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore. Ndonjë konflikt apo kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes duke përfshirë esencën e saj, vlefshmërinë apo përfundimin e saj duhet të zgjidhet nga gjykata kompetente.

Neni 8

Amendamentet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 9

Përfundimi

Palët mund të shkëpusin Marrëveshjen, me akt të njëanshëm duke dhënë 30 (tridhjetë) ditë afat me njoftim paraprak (arsyetim), në formë të shkruar palës tjetër.

Neni 10

Kopjet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe, në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.


Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Faton PEÇI

Ministër i MBPZHR-së



Bashkim RAMOSAJ

Kryetar i Komunës së Deçanit

